

VENDIM
Nr. 62/2013

**PËR KONSTATIMIN E PAVLEFSHMËRISË ABSOLUTE TË VENDIMEVE DHE
KONSTATIMIN E VLEFSHMËRISË DHE LIGJSHMËRISË SË ZGJEDHJES SË ANËTARËVE
DHE KRYETARIT TË KËSHILLIT DREJTUES TË AKEP-IT**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të nenit 105 e vijues të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999, “Kodi i Procedurës Administrative”, të neneve 114 dhe 116 të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Këshillit të Ministrave, bazuar në shqyrtimin në Komisionin për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin dhe në raportin e Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimeve nr. 28/2013, 29/2013, 30/2013, 31/2013 dhe 32/2013 për lirim të anëtarëve dhe Kryetarit të Këshillit Drejtues të AKEP-it.

II. Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimeve nr. 33/2013, 34/2013, 35/2013, 36/2013, 37/2013 dhe 38/2013 për zgjedhjen e anëtarëve dhe Kryetarit të Këshillit Drejtues të AKEP-it.

III. Konfirmimin e vlefshmërisë dhe ligjshmërisë së vendimeve nr. 14, 15, 16, 17 e 19, datë 26.11.2009, dhe nr. 130, datë 13.10.2011, për zgjedhjen e anëtarëve dhe Kryetarit të Këshillit Drejtues të AKEP-it dhe vazhdimësinë e ushtrimit të mandatit të mbetur 5-vjeçar.

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miratuar në datën 14.11.2013